LIGJ
Nr.10 271, datë 22.4.2010

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9655, DATË 11.12.2006 "PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË",TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9655, datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 7, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
"5. Akademikët e Asociuar përfitojnë një shpërblim mujor në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 14/1
Raportimi i Akademisë së Shkencave

Akademia e Shkencave paraqet, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti, informacion për veprimtarinë vjetore pranë Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6554, datë 12.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi